



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA"
UNIVERSITY "KADRI ZEKA"
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.upgi.org tel: 0280390112

Ref. nr. 05/584 Dt. 41 / 06 / 2014

RREGULLORE

për pagesën e anëtarëve të Senatit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan

Gjilan, qershor 2014

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.6/3 të Statutit të Përkohshëm të Universiteti dhe me kërkesë të Senatit të Universitetit, Këshilli i Përkohshëm i Universiteti “Kadri Zeka” në mbledhjen e mbajtur më 11.06.2014, nxori:

**Rregullore
për pagesën e anëtarëve të Senatit të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan**

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet shuma e pagesës së anëtarëve të Senatit për pjesëmarrjen aktive në organizimin e kryerjes së punëve dhe shërbimeve për ushtrimin e detyrave që janë në kompetencë të senatit.

Neni 2

Senati përbëhet nga këta anëtarë:

- Rektori;
- Prorektorët;
- Dekanët e të gjitha njësive akademike sipas këtij Statuti;
- Nga një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike
- Një (1) anëtarë të zgjedhur nga parlamenti i studentëve prej radhëve të studentëve të Universitetit;
- Një (1) anëtar të zgjedhur nga stafi joakademik;
- Sekretari i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të Senatit nga stafi akademik dhe jo akademik është i përkohshëm.

Neni 4

Pagesa për çdo anëtarë të Senatit, do të jetë në shumë lineare prej 70,00 € bruto, në muaj;
Pagesa bëhet për të gjithë anëtarët e Senatit;
Anëtarëve të Senatit nuk u takon kompensimi nëse nuk marrin pjesë në mbledhje.
Anëtari i Senatit i cili mungon nga mbledhja, e cila është mbajtur vetëm një herë në muaj nuk do ta marr kompensimin në vlerë prej 70.00 €, nëse mungesa nuk arsyetohet.

Neni 5

Anëtarët e Senatit obligohen për pjesëmarrje aktive në punimet e Senatit dhe t'i përgjigjen kërkesave të Senatit për kryerjen e punëve nëpër komisione të ndryshme pa kompensim shtesë.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli i Përkohshëm Drejtues. Mënyra e ndryshimit të kësaj Rregullore është e njëjtë me atë të nxjerrjes.

- Këshilli i Përkohshëm Drejtues këtë Rregullore e ka aprovuar në mbledhjen e XII të mbajtur më 11.06.2014.

Gjilan, qershor 2014



Kryetari i KPD
Arben Dërmaku
Prof.Ass.Dr. Arben Dërmaku